



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Olti ShPK" të datës 24.06.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Liceut Artistik – Ndërtesa kryesore" me nr. të prokurimit 616-25-4150-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Olti ShPK" të datës 24.06.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Liceut Artistik – Ndërtesa kryesore" me nr. të prokurimit 616-25-4150-5-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "OLTI" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 24.06.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Liceut Artistik – Ndërtesa kryesore" me nr. të prokurimit 616-25-4150-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritu*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Kërkesa për posedimin e pajisjeve specifike në Aneksin nr. 7 të dosjes së tenderit, konkretisht:

- Aparat për testimin e gypave EN 805/W400
- Makinë mekanike për drejtimin e teheve të sharrës
- Makinë e zdrukthimit, petëzimit ose të gdhendjes me prerje
- Furrë industriale për tharjen e lëndës drusore

Përbën kufizim të pajustificuar dhe të panevojshëm për realizimin e kontratës.

Aparat për testimin e gypave EN 805/W400

Mendojta se është kërkesë e panevojshme sepse aparati për testimin e gypave nuk ka sens që kompania e cila i monton gypat edhe ti testoj prandaj gypat mund të testohen nga një laborator i licencuar për testimin e gypave prandaj mendojmë që kërkesa duhet të jetë që pas montimit të prezantohet certifikata nga laboratori për testimin e gypave.

- Makinë mekanike për drejtimin e teheve të sharrës
- Makinë e zdrukthimit, petëzimit ose të gdhendjes formë nga prerja
- Furrë industriale për tharjen e lëndës drusore

Keto janë pjesë e linjës së Prodhimit dhe këtu hyjnë krejtësisht dhe nuk mund të kerkohen makina ndaras nga linja e prodhimit sepse nuk mund të ndahet ose duhet të kerkohet komplet linja e prodhimit. Gjithashtu duhet të cekim se produktet e drurit vijnë të gatshme dhe nuk ka nevojë për keto pjesë sepse keto pjesë janë të rralla dhe kemi dyshime se po favorizohen kompani të caktuara.

Këto pajisje nuk janë të domosdoshme për realizimin e kontratës sipas përshkrimit të punëve në dokumentet e tenderit. Kërkesa për të është teknike, e specializuar dhe cenon konkurrencën e lirë në tender.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuuese.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë shqyrtuar secila një nga një dhe me këtë rast është gjetur se pajisjet të cilat kërkon parashtruesi që të largohen janë pajisje absolutisht të domosdoshme për realizimin me sukses të projektit. Në anën tjetër as vet parashtruesi nuk ka prezantuar ndonjë kundëragrument sipas të cilit do të mund të konfirmojë e kundërta.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 26.06.2025



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.